
REFERATE E KUMTESA

LUAN MALLTEZI**540 VJET NGA VDEKJA E SKËNDERBEUT¹**

Kronikat dhe arkivat në mesjetë nuk shënojnë zakonisht kohën kur lindin njerëzit që dallohen më pas në veprimtarinë e tyre si udhëheqës të shquar në historinë e vendit, por ato shënojnë në çdo rast ditën kur ata largohen dhe ndërrojnë jetë. Kur ndodh kjo ngjarje e rëndë, koha “nxin”; duke filluar nga kjo kohë njerëzit e humbur tashmë në rrjedhë të ngjarjeve, mbushin me të bisedat në netët që kalojnë. Kjo ndodh nga një brez në tjetrin shekuj me radhë. Koha i shtyn të trajtojnë ndodhitë e kaluara me tymin e legjendave të pafund për jetën dhe veprën e tij². Me këto ata flasin për forcën dhe fuqinë e tij, për “miqtë”, bashkëluftëtarët me të cilët ai luftoi deri në fund. Këta të dhëna që pasurohen në shekuj u duhen edhe historianëve më pas për të përcaktuar prejardhjen e heroit, origjinën dhe të parët e tij, por në këtë pikë ata janë të pafat; çdo krahinë jep të dhëna se ai vjen prej saj³. Dhe kjo është sigurisht e natyrshme; këta

¹ Kumtesë e mbajtur në Prishtinë më 30 mars 2008 në simpoziumin e organizuar nga Universiteti Mbretëror në përkujtim të Kuvendit të Lezhës.

² “Thonë se Skanderbegu ka pa’ le me ni shej shpate n’krah dhe me fletë nan squetëll” (Gurëz-Krujë); “Skëndërbegju ka le me këmishë” (Brest-Dibër), “Skanderbegun s’e zente plumi, s’e pritte shpata, se ka pasë le me kmishë, siç lejnë dragojt” (Macukull-Mat), “Skanderbegun sa ka le prej nane, e kanë pasë lie me do barë fushe orët, prandaj atë s’e zinte plumi, as s’e pritte shpta kurrkun në shtat, veç nar si sjetllat (se i kishin metë pa lie ato)” (Pllan-Lezhë) etj. *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, botim i Institutit të Folklorit, përgatitur nga Q.Haxhihasani, Tiranë, 1967, f.24-25.

³ “Skënderbeu ka lë në Gurs, në mhallë të Kecejt (Krujë)”; “të vjetrit thojshin se Skanderbegju nuk ka le as në Shqefen, as në Muzhakë, por në Gjur të Bardhë” (Mat); “Skanderbeu ka le në Çidhnë të Poshtë (Dibër); “Skënderbegju ka le a rritë n’Kastriot. Atje ka qanë edhe babai i Skënderbegjut”; “Në Kastriot i ka pasë shtëpajat Skënderbegju” (Sinjë-Dibër); “Skanderbegju, simas t’ndëgjumes pleqve, ne dimë se asht prej katunit Kastriot (Dibër)... Atje ka pas banesën e vet. Ka ene sheja të tjera. Atje janë vorret e shtëpisë Skënderbegjut; janë edhe themelet e muret

njerëz në thelb i përkasin gjithë kombit. Vdekja e udhëheqësve të tillë përjetohet kudo, në çdo popull si gjëmë kombëtare.

Kështu ka ndodhur me heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeun.

Skënderbeu hyri që në të gjallë të tij si një legjendë për forcën dhe fuqinë e tij në përfytyrimin e popujve të Ballkanit dhe të Europës; popujt e përfytyronin atë si strateg dhe ushtarak të madh⁴. Ky përfytyrim u krijua në mënyrë të natyrshme nga fakti se ai kishte korrur fitore pas fitore në betejat kundër perandorisë më të madhe politike dhe ushtarake të kohës, Perandoria Osmanë në shek XV.

Vdekja shkaktoi një tronditje të thellë tek bashkëluftëtarët e Skënderbeut. Ata ishin lidhur ngushtë me të për dekada me radhë në një luftë titanike për të mbrojtur me çdo kusht vendin. Skënderbeu u largua nga ata në zjarrin e luftës, në një kohë kur prania e tij si strateg e burrë shteti ishte më e domosdoshme se kurrë. Në Venedik madje thuhej se vendi i tij kishte rënë tashmë thujse tërësisht në duart e turkut.⁵

Xhirardo de Kollis (Girardo de Collis) është ndër të parët që njofton më 12 shkurt dukën e Milanos, Galeaco Maria Sforcën për vdekjen e tij : “Skënderbeu- shkruan ai - u nda kësaj jete; kishte ethe dhe

e rrenueme të kishës. Ka mandej disa kshteja t’vjetra që i thoinë Kshtejat e Skënderbegjut”; “Thonë se në Kastriot janë vorret e familjes së Skënderbegjut. Shtëpija e Gjinve ktu është vendase e rjedhun prej fisit të Kastriotëve” (Brest-Dibër). *Tregime dhe këngë popullore ...*, f.23.

⁴ A.Çoba - Z.Prela, *Albanica* (Vepra të botuara në shek. XVI-XVIII), Tiranë, 1965; K.Biçoku - J.Kastrati, *Bibliografi*, I, Tiranë, 1997; A.Kostallari, *Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, (12-18 Janar 1968), I, Tiranë, 1969, f.371-394; S.Luarasi, *Skënderbeu në letërsinë angleze*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, (12-18 Janar 1968), I, Tiranë, 1969, f.431-438; N.Bulka, *Skënderbeu dhe letërsia frënge*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.349-444; H.Lacaj, *Skënderbeu në letërsinë italiane*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.445-455; shih dhe, F.Franja, *Diskutim rreth kumtesës së H.Lacaj*, po aty, f. 611-612; Y.Jaka, *Skënderbeu në historiografinë frënge*, Prishtinë, 2001.

⁵ “Dicesi chel suo paese he tutto nel mane del Turcho”. J.Radonić, *Gjuragj Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd, 1942, dok.387, f.208.

meqë vendin po e përshkonin turqit, deshi ti hipte kalit, e brenda tri ditëve vdiq”⁶.

Në një çast të tillë njofton vdekjen edhe Barleti. Sipas tij, ushtria u detyrua për herë të parë t’i dilte vetë përballë armikut, pasi prijësi i tyre ishte tashmë i pamundur. Skënderbeu vdiq “po atë natë kur ushtria turke... mori arratinë”⁷.

Nga burimet e pakta që kanë mundur të vijnë nga shek XV, kuptojmë nderimin dhe respektin e madh që bashkëkohësit i bënë në atë kohë udhëheqësit të tyre të lavdishëm.

“Me vdekjen e tij - thuhet në Senatin e Venedikut - arbërit kanë rënë në një ngashërim dhe tronditje të madhe”⁸. Këtë tronditje e përcjell me forcë në ditët tona Lekë Dukagjini me vajtimin, me të cilin i njofton popullit gjëmën që kishte ndodhur tashmë.

“Kur e dëgjoi që po e qanin të vdekur, Lek Dukagjini, princ epirot, ...doli me vrap në mes të pazarit dhe me fytyrë të pikëlluar e me zë të mbytur tha, duke çkulur mjekrën dhe flokët : “Mblidhuni, mblidhuni me vrap të gjithë, o princër dhe sundimtarë arbërorë. Sot u bën copë dyert e Epirit dhe të Maqedonisë, sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona; sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë; sot u përmbysën fronet e pushtet tanë; sot u shua krejt së bashku me këtë njëri çdo shpresë e jonë”⁹

⁶ “Scanderbeg ha passato de questa vita; havea la febbre et, essendo corsi Turchi nel paese, volsi montar a cavalo e mori in tre giorni”. Nagi Nyari, *Acta Estera*, Budapest, 1875, vol.II, 1466-1490, “Monumenta Hungariae Historica”, IV, 1466-1490, nr.59, f.93; S.Ljubič, *Listine o Odnošajih Između Južnoga Slavenstva i Mletačke Republike*, në: “Monumenta Spectantia Historiam Slavorum Meridionalium”, vol.X, Zagreb, 1891, No. CCCCXIII, (12 II 1468), f. 404; S.Romanin, *Storia Documentata de Venezia*, Venice, 1855, vol.IV, f.333; App., No.43; J. Radonić, *vep. e përm.*, dok. 386, f. 208.

⁷ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1967, f.493; J.Radonić, *vep. e përm.*, dok.386, f.208.

⁸ “Sicut per litteras vicerectoris nostri Dyrachii intelligitur mostuus est magnificus quondam Scandarbegus, ob cuius obitum universa illa provincia in magno tumultu et trepidatione est constituta”. J.Radonić, *vep. e përm.*, dok. 387, f. 208; *Historia e Popullit Shqiptar*, I, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, “Toena”, Tiranë, 2002, f.456.

⁹ M.Barleti, *vep. e përm.*, f.494.

Kali i Skënderbeut

Skënderbeu vdiq më 17 janar 1468 në Lezhë¹⁰.

Për të shprehur dhimbjen, Barleti përcjell tregimin e njohur për kalin e Skënderbeut.

“Gjatë kohës që ai po vdiste - shkruan ai – kali, të cilit i hipte kur kish për t’u përleshur, u bë aq shumë i egër, i tërbuar, i pafrenueshëm, sa që s’donte të mbante njeri mbi shpinë dhe pas pak mbaroi”.

Këtë tregim e përmend po ashtu Dhimitër Frengu dhe tradita popullore e arbëreshëve të Italisë.

Arbëreshët

Në këngët e arbëreshëve të Italisë, vdekja e Skënderbeut paralajmërohet si një gjëmë qiellore; moti gjëmonte nga bubullimët, ndërsa toka tronditej dhe çahet.

“Shkoi një ditë mjegullore,
Mjegullore e helmore,
Thua qielli do të vajtojë,
Skënderbeu s’është më.
Dëgjuan shtëpitë dhe u trandën
Dëgjuan malet dhe u çanë,
Këmbanaret e kishave
Zinë kumbuan përreth,
Në qiellin e hapur hynte
Skënderbeu i pafat”.

Sipas një varjanti tjetër të kësaj kënge, mbledhur nga De Rada, yjet mblidhen bashkë të tmerruara dhe bien në tokë, kurse hëna dhe dielli mbyten mbi det.¹¹

Varrimi sipas traditës

Shqiptarët i bënë një nderim të madh të merituar udhëheqësit të vet. Sipas Barletit, Skënderbeu u varros në Lezhë, në kishën e shën Kollit : Ceremonia e varrimit - shkruan ai - u bë sipas zakonit të të parëve, me madhështi të paparë : trupi i tij u përcuall me vaj nga të gjithë ushtarët

¹⁰ Fan S. Noli, *George Castrioti Scanderbeg (1405-1468)*, New York, 1947, f.69.

¹¹ Shaban Sinani, *Kulti i epopesë te De Rada*, “Perla”, Tiranë, nr.1, 2003, f.14-5.

dhe me pikëllim sipas zakoneve të vendit, nga të gjithë princët dhe kapedanët”¹².

Për vdekjen e Skënderbeut shkruan edhe historiani venecian Sabeliko¹³ (1436-1506). Ai tregon se kishte dëgjuar për fuqinë luftarake të Skënderbeut që kur ishte i vogël nga i ati. Ky e kishte njohur Skënderbeun në luftë e sipër kur kishte ardhur në Mbretërinë e Napolit për të ndihmuar Ferdinandin nga fisnikët vasalë që pretendonin pushtetin pas vdekjes së të jatit, Alfonsit V. I ati Sabelikos luftonte atëhere nën komandën e kont Ursinit¹⁴.

Sabeliko shkruan 20 vjet pas vdekjes së Skënderbeut.

“Në mes të zjarrit të luftës, shkruan ai, edhe atëherë kur gjithshka buçiste nga armët e barbarëve, ndër ato qytete, në të cilat ai kishte sunduar, turma vajzash mblidheshin çdo dhjetë ditë në udhëkryqe dhe këndonin lavdinë e të ndjerit princ, ashtu si e kishin zakon të moçmit ndër gostitë e heronjëve”.¹⁵

Populli

Figura e Skënderbeut kaloi në shekuj tek shqiptarët si simbol i luftës për liri dhe pavarësi. “Fytyra e Kastriotit - shkruan Barleti -, ishte ngulitur aq fort në mëndjen e secilit dhe emri e mbretëria e tij ishte skalitur aq thellë në gjokset e të gjithëve sa që do të ishte më lehtë, siç thonë, t’i shkulje Herkulit topuzin nga duart, se sa të fshije nga zëmrat e zjarra të vegjëlisë dashmirësinë dhe dashurinë për Skënderbenë”¹⁶.

¹² M.Barleti, *vep. e përm.*, f. 494.

¹³ Antonius Coccius Sabellicus, *Rerum Venetarum Libri XXXIII*, në: “Istorici delle Cose Veneziane, vol.I, “Venice”, Louisa, 1718.

¹⁴ “Solebat Joannes Coccius, pater meus, qui Calabro bello sub Ruberto Ursino, viro fortissimo, aliquamdiu militavit, adolescenti mihi enarrare, vidisse se Epitoram hominem...” Sabellico, Third Decade, IX, f. 757, Ap., No.49; F.S. Noli, *vep. e përm.*, f. 224, shën. 55.

¹⁵ “Medio ardore belli et tum quum Barbarorum armis omnia strepebant puellarum coetus in his urbibus quibus ille imperavit, octavo quoque die mediis triviis coire solitos ac defuncti Principis, ut veteres magnorum heroum in conviviis solebant, laudes decantare”. Sabellico, IX, 757; Ap.9; F.S. Noli. *vep. e përm.*, f. 220, shën. 71.

¹⁶ M.Barleti, *vep. e përm.*, Tiranë, 1964, f.113, 169, 255.

Populli i thuri atij këngë, tregime, gojëdhëna dhe legjenda¹⁷. Në nderim të tij, banorët e krahinave të ndryshme të vendit shpjegonin historinë e veshjeve të tyre :

“Në thekët e zeza në xhokët e kemi për zi të Skënderbeut” - thoni në vitet 30 banorët e Matit.¹⁸ “Kto xhamandanë, kto xhupa e shallvare t’zeza që majmë ç’prej kohës që vdiq Skënderbeu”. Me Skënderbeun dhe flamurin e tij shpjegonin edhe banorët e Bulqizës veshjen e grave të tyre”. “Pleqtë na thojshin se flamuri i Skënderbeut ka qanë kuq e zi. Prandaj edhe gratë tona vishen me qashe të zeza e me spika të kuqe”. (Bulqisë, Dibër, 1950).

Populli shpjegonte me emrin e Skënderbeut edhe flamurin kombëtar. Ngjyra kuq e zi e flamurit të Skënderbeut - thonin në vitet ‘50 banorët e Breshtit të Dibrës, - është ruajtur shumë kohë pas vdekjes së Skënderbeut. “Arkat e nuseve të reja, thonin ata, i lejshin me kuq e zi përmrena, pse jashtë nuk i linte Turqia”.

Gojëdhëna të tilla, lidhur me Skënderbeun dhe luftërat e tij u krijuan edhe nga shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë¹⁹. Krijime të tilla krijuan edhe arbëreshët, shqiptarët që u detyruan të mërgonin në Kalabri pas vdekjes së Skënderbeut²⁰. Në fondin e këngëve të magjishme për “dheun që lanë“ dhe “Motin e Madh“ të Skënderbeut ishin edhe ato vargje që shprehin dëshirën e Skënderbeut për të qenë gjithmonë në krye të luftës për liri:

¹⁷ L.Kokona, *Skënderbeu në letërsinë e sotme shqipe*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, (12-18 Janar 1968), I, Tiranë, 1969, f. 461- 470.

¹⁸ *Tregime dhe këngë popullore ...*, f. 205.

¹⁹ A.Çeta, *Fytyra e Skënderbeut në traditën popullore*, Simpoziumi për Skënderbeun (Simpozium o Skenderbegu) 9-12 maj 1968, f. 278-279.

²⁰ M.Xhaxhiu, *Epoka dhe figura e Skënderbeut në disa nga poemat arbëreshe*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f. 401-410; K.Kodra, *Figura e Skënderbeut në krijimtarinë e De Radës*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.411-420; Z.Chiamonte, *Kujtimi i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në etnokulturën arbëreshe të Sicilisë*, në: “Skënderbeu dhe Evropa”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2006, f. 385-389; K. Kodra, *Figura e Skënderbeut në letërsinë arbëreshe*, në: “Skënderbeu dhe Evropa”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2006, f. 402-407.

“Përmi kalë, erës detit,
 hapni ju flamurin tim,
 dhe në mes të këtij flamuri,
 lini varuar shpatën time,
 kur të frynj’ murgjari i egër,
 murgjari do t’i hingëllinjë,
 edhe shpata do tringëllojë,
 nga ky qiparis i vrënjtur.
 Dëgjon Turku dhe i trembur,
 do kujtonj ai vdekjen
 që po flë te shpata ime
 s’do t’ju bjerë më nga pas”.

Kështu edhe ndodhi. Me emrin e tij shqiptarët morën kurajo të ngriheshin kundër sundimit osman në periudhën e Rilindjes Kombëtare²¹. Në Kuvendin e Vlorës, figura e Skënderbeut qëndronte në ballë të delegatëve që shpallën aktin e pavarësisë. Emri i Skënderbeut i udhëhoqi shqiptarët edhe në luftën për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë dhe nazistë. Qindra artikuj që iu drejtuan popullit mbanin emrin e tij²². Shqiptarët kryen po ashtu hulumtime në arkiva të huaja për të ndriçuar mbi bazën e fakteve historinë e tij²³. Emri dhe figura e tij ndodhet në të gjithë krijimtarinë artistike të popullit tonë²⁴ dhe fushën mediatike²⁵.

²¹ R.Brahimi, *Skënderbeu në letërsinë e Rilindjes Kombëtare*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.395-400; Z. Reso, *Skënderbeu dhe epoka e tij në shtypin e Rilindjes sonë kombëtare*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f. 455-460; shih dhe A. Kondo, *Diskutim rreth kumtesës së Z.Resos*, po aty, f. 613-615.

²² V.Boshnjaku, *Figura e Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Luftën nacionalçlirimtare*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.359-364.

²³ Ajet Shahu, *Figura e Skënderbeut në këndvështrimin e regjimit komunist*, në: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në historinë e shqiptarëve”, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2005, f.229-248.

²⁴ B.Gjergji, *Mbi Skënderbeun mediatik*, “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në historinë e shqiptarëve”, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2005, f.248-256.

²⁵ I.Çausi, *Skënderbeu në artet figurative*, në: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në historinë e shqiptarëve”, Republika e Shqipërisë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti

Monumenti i Skënderbeut zë vendin qendror në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” në Tiranë, dhe po ashtu qëndron në Prishtinë dhe në Shkup. Shqiptarët janë të lidhur ngushtë me të; ai qëndron para tyre si një prijës që shënoi rrugën e lirisë.

i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2005, f.216-228; Dh.Dhamo, *Skënderbeu në artet figurative shqiptare*, në: “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.517-548; O.Paskali, *Mendime rreth figurës së Skënderbeut në artin figurativ evropian*, “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, 12-18 Janar 1968, I, Tiranë, 1969, f.449-550.